Vendim nr. 94, datë 12.10.2026

(V- 94/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Asim Vokshi, Marsida Xhaferllari anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 12.10.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 40 (E) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ERDI PRIFTI, NATASHA SOTIR (PRIFTI), LLUIZA BINJAKU (PRIFTI)**

SUBJEKT I INTERESUAR:

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatja e shtetit, Denisa Skënderaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-3010, datë 26.06.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm të çështjes civile nr. 21234-05074-30-2024, nr. 2702 akti, datë 02.12.2024, të regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Konstatimi i shkeljes të së drejtës për proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues. Detyrimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të gjykojë çështjen e kërkuesve brenda 6 (gjashtë) muajve.

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 43, 124, 131, shkronja "f", dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1, dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 49, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës**

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve Erdi Prifti, Natasha Sotir (Prifti), Lluiza Binjaku (Prifti) *(kërkuesit)*, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit, në cilësinë e viktimës, në datën 09.12.2020 kanë dorëzuar një kallëzim penal, për të cilën Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (*Prokuroria e Korçës*), në datën 08.02.2021, ka regjistruar procedimin penal për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, të parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë, i Kodit Penal. Njëkohësisht kërkuesit kanë paraqitur edhe padi civile për kthimin dhe lirimin e pronës së tyre, e cila, sipas tyre, iu është nënshtruar transaksioneve mbi bazën e akteve të falsifikuara. Ky proces është pezulluar në datën 23.06.2021 deri në përfundimin e çështjes penale.

2. Për shkak të tejkalimit të afateve të hetimit, kërkuesi Erdi Prifti, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor edhe të kërkuesve të tjerë, bazuar në nenet 399/1, 399/2, pikat 1, shkronja "ç" dhe 2, 399/5, 399/6 e vijues të Kodit të Procedurës Civile *(KPC*), i është drejtuar gjykatës me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të hetimit (*kërkesa për përshpejtimin e procedurave*). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2022-377 (53 prot.), datë 14.12.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

3. Në datën 13.04.2023 kërkuesi Erdi Prifti ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin nr. 6, datë 15.02.2024 (*vendimi për konstatimin e shkeljes*), ka vendosur pranimin e tij, shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm dhe detyrimin e Prokurorisë së Korçës për përfundimin e hetimeve me përparësi. Vendimi është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 50, datë 20.03.2024.

4. Në vijim, të tre kërkuesit kanë ngritur padi në gjykatë për shpërblimin e dëmit nga vonesa bazuar në nenet 399/1 – 399/11, e vijues të KPC-së. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me vendimin nr. 41-2024-2717 (780), datë 25.07.2024, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë

së Financave t'i paguajnë solidarisht kërkuesve masën e dëmshpërblimit prej 240.000 lekë, si dëm jopasuror për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të hetimit të çështjes. Kundër vendimit kanë paraqitur apel Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Prokuroria e Korçës. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 21234-05074-30-2024, nr. 2702 akti., datë 02.12.2024.

5. Në datën 05.03.2025, me argumentin se kishte kaluar afati ligjor 3-mujor i shqyrtimit të çështjes, kërkuesit kanë paraqitur kërkesë për përshpejtim. Në mungesë të përgjigjes, në datën 14.04.2025, ata i janë drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së shpërblimit të dëmit dhe përshpejtimin e procedurave.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3010, datë 26.06.2025, të marrë në dhomën e këshillimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se nuk kishte shkelje të afatit të arsyeshëm. Sipas Gjykatës së Lartë, në përllogaritjen e afatit duhet të mbahen në konsideratë rrethanat që kanë sjellë pamundësinë objektive për procedimin e çështjes. Ajo ka arsyetuar se vonesa në gjykim ka ardhur si pasojë e ngarkesës së jashtëzakonshme, pra jo nga mungesa e vullnetit të gjyqtarit relator, i cili ka planifikuar për gjykim çështjet e regjistruara gjatë viteve 2017–2025, duke respektuar rendin kronologjik dhe prioritetin e disa çështjeve për shqyrtim.

7. Në datën 31.12.2025 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, në datën 16.02.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesit***, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimi i kundërshtuar u ka cenuar atyre *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.1. *E drejta e për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi ka më shumë se 1 vit që gjykata e apelit nuk shprehet me vendim për çështjen e tyre, duke shkelur afatin 3-mujor të përcaktuar në nenin 399/2, pika 2, të KPC-së. Institucionet e përfshira në këtë proces po përpiqen në çdo formë për të zvarritur procesin gjyqësor.

8.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme,* pasi Gjykata e Lartë ka vepruar pa shqyrtuar çështjen përderisa nuk arsyeton vendimin në lidhje me nenet 399/1, 399/7 e vijues të KPC-së.

8.3. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar çështjen mbështetur në parashikimet e legjislacionit procedural civil dhe as mbi jurisprudencën kushtetuese të Gjykatës.

8.4. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi është i paarsyetuar sipas përcaktimeve të nenit 142, pika 1, të Kushtetutës dhe bie ndesh dhe me vetë argumentet e tij.

9. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se argumentet për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* janë të paarsyeshme dhe të pabazuara, pasi:

9.1. Shqyrtimi i çështjes së kërkuesve në gjykatën e apelit nuk ka tejkaluar afatin dyvjeçar të parashikuar nga neni 399/7 i KPC-së. Vonesa në shqyrtimin e mosmarrëveshjes së tyre është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin. Kërkuesit e kanë realizuar të drejtën në themel për çështjen për të cilën është konstatuar shkelja e afatit të arsyeshëm nga Gjykata. Pretendimet e ngritura kanë të bëjnë me afatin e arsyeshëm të gjykimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit. Tejzgjatja e procedurave gjyqësore nuk paraqet shkallë rreziku për interesat e kërkuesve.

9.2. Mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime në kundërshtim me ligjin të gjyqtarit. Shqyrtimi i çështjeve nga gjykata, në respektim të parimit të prioritetit në kohë, realizohet duke marrë në konsideratë çështjen më të hershme të regjistruar. Analiza dhe arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë janë ezauruese dhe të plota, duke u dhënë përgjigje të argumentuara me referenca ligjore dhe jurisprudencë kushtetuese të gjitha pretendimeve.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës,

pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Për sa i takon legjitimimit *ratione personae,* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se është viktimë e një shkeljeje të të drejtave themelore. Interesi duhet të jetë vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real. Në rastin e ankimeve për të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata ka pohuar se, në parim, statusi i "viktimës" përjashtohet vetëm nëse organet publike kanë njohur shkeljen, në mënyrë të shprehur ose në substancë, dhe më pas e kanë riparuar atë (*shih vendimet nr. 45, datë 11.06.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, rezulton se Gjykata u ka njohur kërkuesve cenimin e së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të hetimeve, ndërsa gjykata e shkallës së parë, në kuadër të korrigjimit të pasojave të kësaj shkeljeje, u ka akorduar atyre dëmshpërblim në masën 240.000 lekë. Megjithatë, procesi i korrigjimit të shkeljes së konstatuar nuk ka përfunduar ende, pasi vendimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar nga institucionet shtetërore të ngarkuara me ekzekutimin e tij. Për këtë arsye, vendimi nuk është ekzekutuar, ndërsa çështja vijon të jetë në pritje të shqyrtimit nga gjykata e apelit prej datës 02.12.2024. Në këto rrethana, ndonëse cenimi i së drejtës themelore është njohur nga Gjykata, korrigjimi efektiv i pasojave të tij mbetet ende në proces, çka nënkupton se kërkuesit nuk e kanë humbur statusin e viktimës. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh se përshtatshmëria dhe efektiviteti i mjetit kompensues nuk janë materializuar ende në një korrigjim konkret të shkeljes, Gjykata çmon se kërkuesit vijojnë të kenë interes në çështjen e parashtruar dhe, si të tillë, legjitimohen *ratione personae.*

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive,* të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i Ligjit Organik, Gjykata ka theksuar se kur shqyrtohet tejzgjatja e çështjes së kompensimit nga vonesa, si mjet juridik korrigjues, individit nuk mund t'i kërkohet të shterojë sërish mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, pasi kjo do t'i ngarkonte atij një barrë të tepruar dhe do të cenonte vetë qëllimin e këtyre mjeteve (*shih vendimet nr. 45, datë 11.06.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata vlerëson se ky kriter konsiderohet i përmbushur, ndërsa fakti që kërkuesit u janë drejtuar gjykatave të zakonshme me kërkesë për konstatimin e vonesës nuk ka rëndësi në aspektin kushtetues, pasi përbën vetëm një rrugë juridike të ndjekur prej tyre, e cila nuk kushtëzon vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues nga pikëpamja e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion.

14. Për sa i takon kriterit *ratione temporis*, të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik, sipas të cilit kërkesa paraqitet brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit, Gjykata ka theksuar se kur shkelja e pretenduar përbën një situatë të vazhdueshme, ky afat fillon të ecë vetëm me përfundimin e saj (*shih vendimet nr. 45, datë 11.06.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, për sa kohë çështja e kërkuesve në gjykatën e apelit ende nuk ka përfunduar dhe pretendimi lidhet me efektivitetin e mjetit juridik kompensues në drejtim të kohëzgjatjes së tij, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor.

15. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesit kanë kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për shkak të mosshqyrtimit brenda një afati të arsyeshëm nga gjykata e apelit të ankimit të paraqitur nga institucionet shtetërore kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të cilin u është akorduar dëmshpërblim për kohëzgjatjen e paarsyeshme të hetimeve mbi kallëzimin e tyre, si dhe konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv. Po kështu, ata kanë pretenduar cenimin nga Gjykata e Lartë të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme, të parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke parashtruar se procesi i kompensimit për shkeljen e konstatuar po zvarritet qëllimisht prej më shumë se një viti. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre, lidhen, në thelb, me efektivitetin e mjetit juridik kompensues për korrigjimin e shkeljes së konstatuar të së drejtës themelore, ndaj, në vijim, do t'i shqyrtojë ato në këtë këndvështrim, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për konstatimin e shkeljes të së drejtës për proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues

16. Kërkuesit kanë parashtruar se gjykata e apelit nuk ka marrë vendim për çështjen e tyre prej më shumë se një viti, në tejkalim të afatit ligjor 3-mujor, dhe institucionet shtetërore të përfshira në proces po e zvarrisin qëllimisht atë. Sipas tyre, Gjykata e Lartë e ka rrëzuar kërkesën për përshpejtim pa e shqyrtuar çështjen në përputhje me ligjin dhe jurisprudencën kushtetuese, ndërsa vendimi i saj është i paarsyetuar dhe përmban kundërthënie në argumentim.

17. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara, pasi nuk është përmbushur afati dyvjeçar i parashikuar nga neni 399/7 i KPC-së. Sipas saj, vonesa në shqyrtimin e çështjes lidhet me problematika të përgjithshme të sistemit gjyqësor dhe nuk rrezikon interesat e kërkuesve. Gjithashtu, vonesa nuk është shkaktuar nga veprime ose mosveprime subjektive të gjyqtarëve, pasi çështjet shqyrtohen sipas

radhës së regjistrimit të tyre, ndërsa Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje të arsyetuara të gjitha pretendimeve, në përputhje me ligjin dhe me jurisprudencën kushtetuese.

18. Gjykata ka theksuar se padia për shpërblimin e dëmit, në rastet kur është konstatuar cenimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duhet të shqyrtohet me shpejtësi, në mënyrë që mjeti kompensues të ruajë efektivitetin e tij. Për këtë qëllim, shqyrtimi i kësaj padie iu nënshtrohet afateve dhe rregullave të posaçme procedurale, të ndryshme nga ato që zbatohen për padinë e zakonshme për shpërblimin e dëmit, me synimin për të shmangur vonesat që mund të shkaktohen nga zbatimi i rregullave të përgjithshme të procedurës civile. Në këtë kuptim, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor të një mjeti që synon të korrigjojë pasojat e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore nuk mund të jetë e tillë që ta zhveshë atë nga efektiviteti praktik. Çdo interpretim i ndryshëm do të binte ndesh me qëllimin dhe objektin e këtyre dispozitave (*shih vendimet nr. 45, datë 11.06.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në funksion të garantimit të shqyrtimit të shpejtë dhe efektiv të mjetit kompensues, ligjvënësi ka parashikuar afate të posaçme dhe të shkurtra në nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Në veçanti, neni 399/7, pika 1, i KPC-së përcakton afatin 3-mujor për gjykimin e kërkesëpadisë për shpërblimin e dëmit, nga data e depozitimit të saj. Kjo dispozitë, e lexuar së bashku me nenin 399/6, pika 3, të KPC-së, evidenton nevojën për shqyrtimin me përparësi të këtyre çështjeve. Natyra e posaçme e këtij gjykimi kërkon që edhe shqyrtimi i çështjes në gjykatën e apelit të zhvillohet me shpejtësi, pa iu nënshtruar afateve të përgjithshme të gjykimit, pasi vonesat e tepruara në këtë fazë mund të pengojnë ekzekutimin e vendimit që ka njohur të drejtën e shpërblimit të dëmit, duke cenuar efektivitetin e mjetit kompensues. Për rrjedhojë, ndonëse afati 3-mujor i parashikuar nga neni 399/7, pika 1, i KPC-së zbatohet për gjykimin në shkallë të parë, ai duhet të shërbejë si orientim edhe për shqyrtimin e çështjes në gjykatën e apelit, në përputhje me qëllimin e ligjvënësit për të garantuar korrigjimin sa më të shpejtë dhe efektiv të shkeljes së konstatuar (*shih vendimet nr. 45, datë 11.06.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesve iu është njohur e drejta për dëmshpërblim në masën 240.000 lekë, për shkak të tejzgjatjes së hetimeve nga prokuroria lidhur me kallëzimin e tyre për përdorimin e dokumenteve të falsifikuara nga të tjerë, si pasojë e të cilave pretendojnë se u janë cenuar të drejtat e pronësisë. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë për caktimin e dëmshpërblimit është ankimuar nga institucionet shtetërore të ngarkuara me ekzekutimin e tij dhe, ndonëse çështja është regjistruar në gjykatën e apelit në datën 02.12.2024, ende nuk është caktuar një datë për shqyrtimin e saj. Pas kalimit të afatit 3-mujor kërkuesit i janë drejtuar gjykatës së apelit me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, por

nuk kanë marrë përgjigje. Në këto rrethana, ata i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të mosshqyrtimit të çështjes së tyre brenda afatit 3-mujor. Megjithatë, Gjykata e Lartë e ka rrëzuar kërkesën, duke arsyetuar se vonesa në shqyrtimin e çështjes nuk lidhet me shkaqe subjektive ose qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, por me problematika objektive të funksionimit të gjykatës, të shkaktuara nga ngarkesa e lartë dhe akumulimi ndër vite i çështjeve gjyqësore. Sipas Gjykatës së Lartë, gjyqtari relator ka ndjekur kriterin e përparësisë kohore në shqyrtimin e çështjeve, duke qenë ende në proces shqyrtimi dhe planifikimi të çështjeve të regjistruara në vitin 2017. Për rrjedhojë, ajo ka vlerësuar se kur pamundësia për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm shkaktohet nga rrethana objektive, të pavarura nga vullneti i gjykatës dhe nga sjellja e gjyqtarit, nuk mund të konsiderohet se është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (*shih paragrafët 11 - 13 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

21. Për sa më sipër, Gjykata vëren se qëndrimi i Gjykatës së Lartë është mbështetur në argumente të përgjithshme që lidhen me pasojat e situatës në gjykatën e apelit në drejtim të ngarkesës me çështje të gjyqtarit relator, si dhe me mungesën e një parashikimi të shprehur ligjor për afatin e zbatueshëm për këtë lloj gjykimi në gjykatën e apelit, pa mbajtur parasysh standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se interpretimi i ngushtë i nenit 399/7 të KPC-së, duke e justifikuar vonesën në shqyrtimin e çështjes së kërkuesve me pamundësinë objektive të gjykatës së apelit, jo vetëm që u ka ngarkuar atyre një barrë të tepruar, por bie ndesh edhe me qëllimin e mjetit kompensues, duke cenuar efektivitetin e tij në garantimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Gjykata e çmon të pabazuar edhe prapësimin e subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, i cili, duke riprodhuar arsyetimin e Gjykatës së Lartë, ka argumentuar se ngarkesa e gjyqtarit relator përbën pamundësi objektive dhe nuk lidhet me veprime ose mosveprime subjektive të tij. Një argument i tillë nuk mund të justifikojë, në aspektin kushtetues, vonesën në shqyrtimin e çështjes, pasi bie ndesh me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës, sipas së cilës pasojat e vonesave të shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi nuk duhet të rëndojnë mbi palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese).*

22. Ky vlerësim vjen në qasje me qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*)-së, e cila ka shprehur shqetësimin se sistemi shqiptar aktual dykahësh i mjeteve për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave kërkon, pas konstatimit nga një gjykatë më e lartë të shkeljes së kërkesës për "afat të arsyeshëm", paraqitjen e një padie të veçantë për kompensim në gjykatën e shkallës së parë, masë e cila ka potencialin jo vetëm të zgjasë kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave në çështjet individuale, por edhe të shtojë barrën e

një sistemi drejtësie tashmë të ngarkuar. Duke mbajtur parasysh edhe faktin se numri i çështjeve në të cilat është dhënë kompensim në këtë kontekst mbetet ende shumë i kufizuar, GJEDNJ-ja ka nxitur autoritetet vendase të marrin në konsideratë efikasitetin praktik të mjetit kompensues sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së *(shih ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, 27.05.2025, § 192).*

23. Nisur nga konteksti i çështjes konkrete, Gjykata thekson gjithashtu se konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues, synon të sigurojë korrigjimin efektiv të shkeljes së konstatuar më parë, përmes përshpejtimit të shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit dhe zbatimit prej saj të dispozitave procedurale në përputhje me standardet kushtetuese të sipërpërmendura. Ky konstatim nuk përbën njohjen e një shkeljeje të re dhe as krijon për kërkuesit një të drejtë të re për kompensim për shkak të kohëzgjatjes së procesit, por synon të garantojë që mjeti kompensues, i vënë në lëvizje për korrigjimin e shkeljes fillestare, të mos humbasë efektivitetin e tij për shkak të vonesave në shqyrtimin gjyqësor.

24. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve në lidhje me mungesën e efektivitetit të mjetit kompensues janë të bazuara, sipas arsyetimit të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konstatimin e shkeljes të së drejtës për proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues.
3. Urdhërohet Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 12.10.2026

Shpallur më 27.10.2026